

Nëntëmbëdhjetë përfaqësues të OJQ've në Kosovë i shkruajnë Bashkimit European dhe shteteve anëtare për të kërkuar që Kosova të trajtohet në procesin e liberalizimit të vizave. Ata thonë se kosovarët janë të diskriminuarit e BE'së. Veton Surroi akuzon Qeverinë e Kosovës se nuk i ka kushtuar kujdes kërkeseve të Brukselit. Në mesin e të mënskruarve në letër, edhe Rada Trajkovic.

#### Përparrim Isufi

perparim.isufi@gazetaexpress.com


PRISHTINË, 21 KORRIK — Shqipëria civile në Kosovë ka kërkuar nga Bashkimi European që ta rishqyrtojë qendrimin e Komisionit Evropian përmospërfishtjen e Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave.

Përmes një letrë të nënshkruar nga 19 përfaqësues të shoqërisë civile, Brukseli thirret që të gjiejë mënyrën që konsensusi për përashtim të Kosovës nga liberalizimi i vizave ta shndërrojë në konsensus përmospërfishtjen e saj në këtë proces.

Nga pesë shtete të rajonit në garë për lehtësimin e udhëtimit të qytetarëve të tyre nëpër shtetet e BE'së, vetëm Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi kanë përfishtuar mundësinë që ta bëjnë këtë që nga fillimi i vitit të ardhshëm. Shqipëria dhe Bosnja e Hercegovina, ana e tjeter, presin që ta kapin rastin me një vit vonesë.

Por, Kosova nuk është përfshirë fare në këtë proces për shifikat se pesë shtete të BE'së ende nuk e kanë njohur pavarsinë e Kosovës prandaj nuk është arritur pajtimi në Bruksel përrugën të cilën duhet ta ndjekë shteti i ri gjatë procesit.

Eksponentët të shoqërisë civile janë shprehur të shqetësuar që Kosova është lënë jashtë këtij pro-



# NA SHKELET DINJITETIN

cesi.

"Kjo rrezikon që Kosova të shndërrrohet në një geto vizash pa kurfarë rrugëdalje", thuhet në letrën në të cilën politikat e Komisionit Evropian në këtë çështje vlerësohen si "të pakuptimata dhe diskriminuese" ndaj qytetarëve të Kosovës.

Letra është nënshkruar edhe nga lideri serbë të Kosovës, Rada Trajkovic por në cilësinë e mjekes nga Graçanica.

"Të izolohen qytetarët e Kosovës dhe të bëhet presion shtesë

mbi serbët e Kosovës, duke i vëçuar të gjithë si rezik i posaçëm sigurie, është fjerje e pabazë. Propozimi i Komisionit Evropian e nënverhësmon mundin tonë për ta ndërtuar një Kosovë të hapur dhe multietnik", thuhet në letrën.

Veton Surroi nga Klubi për Politikë të Fashme, si njëri nga nënshkruesit e letrës, ka thënë se Kosova e izoluar në çështjen e liberalizimit të vizave do të jetë e izoluar edhe në proceset e ardhshme integruuese të vendit.

"Sot njëra prej formave me të

cilat i shkelet dinjiteti qytetarëve të Kosovës nga një bashkësi ndër-kombëtare e cila është e interesuar ta ndihmojë Kosovën, është në çështjen e vizave. Shkoni sot në ambasadat këtu në Kosovë ose në Shkup dhe do të shihni se si ka degraduar qasa ndaj qytetarëve të Kosovës dhe sot jemi më keq se që kemi qenë para 10-15 vjetësh", është shprehur Surroi.

Ai ka thënë se te institucionet e Kosovës ka munguar kujdesi ndaj kësaj çështjeje.

"Është evidente se nuk ka pa-

sur as kujdes minimal në trajtimin e çështjeve teknike dhe kjo nuk është vetëm tash por edhe më herët. Që në kohë kur kemi qenë në bisidime në Ekipin e Unitit kam insistuar që pasaporta e Kosovës të jetë biometrike", ka thënë Veton Surroi.

Pasaportat biometrike janë një ndër katër kushtet që i parashtron Komisioni Evropian një shteti për të hyrë në proces të liberalizimit të vizave, prandaj Surroi ka thënë se qeveria e Kosovës ka qenë dashur që të mos ia lejojë këtë alibi Brukselit ta përdorë kundër Kosovës.

Analistja gjermane Verena Knaus thotë se propozimi i Komisionit Evropian është diskriminues për qytetarët e Kosovës.

"Procesi i liberalizimit të vizave dhe njohja e Kosovës duhet të ndahen si çështje. Nëse 27 shtetet anëtare të BE-së ishin të gatshme të pajtoheshin për të vendosur Kosovën si territor në listën e zezë, duke u imponuar viza qytetarëve, ato nijëtë mund të pajtohen që ta fusin Kosovën në listën e bardhë", thotë Verena Knaus nga Iniciativa Evropiane për Stabilitet (ESI).

**Nënkyetari i AAK'së, Blerim Shala ka thënë se skena politike duhet të njihet me problemet që ekzistonjë në vend. Prandaj, sipas tij, Qeveria e Kosovës nuk duhet t'u shmanget temave që ngriten nga AAK'ja.**

Prishtinë, 21 korrik —

Nënkyetari i Parë i AAK'së, Blerim Shala i ka kërkuar Qeverisë së Kosovës që mos t'i shmanget temave që ka ngritur opozita.

"Realistët skena politike e Kosovës duhet të njihet me problemet, që ekzistonjë në shoqërinë

## Nuk duhet shmangur

e Kosovës. Dhe para se gjithash qeverisë së Kosovës i nevojitet që të trajtojë problemet shumë konkrete të cilat faktikisht kanë filluar ta vërhojnë Kosovën", ka thënë ai në një intervistë për Radiana Europa e Lirë.

"Ekziston një qasje, përbindjen time krejtësisht e paqëndrueshme e shmangjes së vëmendjes dhe përqendrimit prej rasteve konkrete në "përplesjet" midis PDK'së dhe AAK'së", ka shkruar ai.

Nënkyetari i Parë i AAK'së, në

këtë intervistë ka folur edhe rreth përgatitjeve të kësaj partie për zgjedhjet lokale të 15 Nentorit.

"Në jemi në proces të konsultimeve brenda partisë, në procesin vendimarrës për të gjitha komunitat e mbetur, ju e dini që i kemi përcaktuar 15 kandidatë për kryetarë të komunave, prandaj edhe në këtë kontekst jemi duke e shqyrtuar edhe rastin e Prishtinës, i cili është rasti i veçantë, e dinë se çfarë rëndësie ka kryeqyteti i Kosovës", ka deklaruar Shala.

Aj ka shmangur pyjetës nëse do të kandidojet për postin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës.

"Aktualisht, AAK akoma nuk ka vendosur për kandidatin e saj për Kryetar të Komunës së Prishtinës", ka thënë ai.

Në këtë intervistë, Blerim Shala ka folur edhe rreth bisidimeve mes EULEX-it dhe Beogradit, rreth procesit të njohjes së pavarsisë së Kosovës dhe për procesin e Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.

